

No. 26856

**FRANCE
and
ALBANIA**

**Cultural, Scientific and Technical Agreement. Signed at
Tirana on 17 February 1988**

Authentic texts: French and Albanian.

Registered by France on 6 October 1989.

**FRANCE
et
ALBANIE**

**Accord culturel, scientifique et technique. Signé à Tirana le
17 février 1988**

Textes authentiques : français et albanais.

Enregistré par la France le 6 octobre 1989.

[ALBANIAN TEXT — TEXTE ALBANAIS]

MARREVESHJE KULTURORE, SHKENCORE E TEKNIKE NDERM-JET QEVERISE SE REPUBLIKES FRANCEZE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES POPULLORE SOCIALISTE TE SHQIPERISE

Qeveria e Republikës Franceze dhe Qeveria e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, të nisura nga dëshira për të lehtësuar e zhvilluar bashkëpunimin dhe shkëmbimet midis Francës dhe Shqipërisë në fushat e kulturës, edukimit, arsimit, shkencës, teknikes dhe arteve, të bindura se ky bashkëpunim do të kontribuojë në forcimin e marrëdhënieve të tyre, u moren vesh për sa vijon:

Neni 1

Palet kontraktuese propozojnë të zhvillojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimet e tyre në fushat e kulturës, edukimit, arsimit, shkencës, teknikes, arteve, radiodifuzionit dhe të televizionit, kinemase, rinisë, sporteve dhe turizmit.

Neni 2

Secila Pale kontraktuese do të inkurajojë dhe favorizojë në territorin e vet mesimin e gjuhës dhe njohjen e qyteterimit të Pales tjetër kontraktuese.

Neni 3

Palet kontraktuese do të lehtësojnë:

- a) Krijimin e katedrave në institucionet e arsimit të lartë;
- b) Shkëmbimin e profesoreve, lektoreve, asistanteve, studenteve, studiuesve, personalitetëve në fushën e kulturës dhe shkencës, si dhe përgjegjësve të grupeve kulturore.

Neni 4

Secila Pale kontraktuese do të perpiqet të shtojë dhenien e bursave për studentët dhe studiuesit e të gjitha disiplinave të Pales tjetër që dëshirojnë të ndjekin studimet ose të perfeksionohen në vendin e tyre.

Neni 5

Secila Pale kontraktuese do të lehtësojë njohjen e studimeve të bera, të provimeve dhe diplomave të fituara në shtetin tjetër, për të vazhduar studimet në territorin e vet.

Neni 6

Palet kontraktuese :

- a) Do të favorizojnë shkëmbimin e profesoreve, të mesuesve, të eksperteve, të studiuesve, specialistëve të të gjitha disiplinave dhe në përgjithësi të personalitetëve kulturore, shkencore dhe artistike që do të kryejnë misione, qendrimë dhe stazhe perfeksionimi, do të zhvillojnë konferenca në shtetin tjetër ose që do të ndermarrin studime ose kërkime.

b) Do te inkurajojne pjesemarrjen e ketyre personave ne kongrese, konferenca, simpoziume ose festivale te organizuara ne vendet e tyre.

Neni 7

Palet kontraktuese do te inkurajojne shkembimet ndermjet organizmave te radiodifuzionit dhe televizionit te dy shteteve.

Ato do te favorizojne perhapjen e filmave dhe do te inkurajojne bashkepunimin dhe shkembimet ndermjet sinematekave te tyre. Ato do t'u lehtesojne institucioneve dhe organizmave te interesuara shfaqjen dhe huazimin e filmave dhe diapozitivave, veçanerisht nepermjet sherbimeve te tyre kulturore perkatese.

Neni 8

Palet kontraktuese do te favorizojne shkembimet e artisteve, te ansambleve artistike si dhe dhenien e shfaqjeve lirike, koreografike dhe teatrale.

Ato do te inkurajojne organizimin e ekspozitave kulturore, artistike, shkencore si dhe te ekspozitave te librit dhe te periodekeve.

Ato do te inkurajojne gjithashtu ne fushen e muzikes paraqitjen e veprave, te disqeve dhe te bandave manjetike si dhe shkembimin e informacioneve mbi jeten muzikore.

Neni 9

Palet kontraktuese:

a) Do te inkurajojne importimin e librave, te periodekeve dhe botimeve te tjera qe kane te bejne me arsimin, shkencat, tekniken, letersine, artet. Ato do te bejne perjekje per te lehtesuar shitjen e botimeve kulturore te Pales tjetër.

b) Do te japin, brenda mundesive qe kane, ndihmen e tyre ne shkembimet e veprave kulturore, shkencore e teknike si dhe te dokumentacionit midis bibliotekave dhe institucioneve te specializuara. Ato do te shtojne brenda mundesive te tyre perjekjet ne kete fushë me huazime ose dhurata.

c) Do te inkurajojne perkthimin dhe botimin e veprave me perfaqesuese ne fushat e shkences, teknikes, letersise dhe arteve. Ato do te favorizojne realizimin e botimeve te perbashketa ne revista te specializuara, te artikujve te shkruar nga personalitete shkencore dhe kulturore te Pales tjetër.

Neni 10

Palet kontraktuese do te favorizojne shkembimet e te rinjve.

Neni 11

Palet kontraktuese deklarojne se do te favorizojne zhvillimin e shkembimeve te tyre ne fushat e sportit dhe te edukimit fizik.

Neni 12

Palet kontraktuese do te favorizojne zhvillimin e shkembimeve turistike.

Neni 13

Palet kontraktuese do te inkurajojne vadosjen e marrredhenieve ndermjet institucioneve kulturore, shkencore, artistike dhe te arsimit te larte.

Ato do te inkurajojne veçanerisht bashkepunimin ndermjet institucioneve shkencore e teknike per hartimin e projekteve me interes te ndersjellte.

Neni 14

Palet kontraktuese do te lehtesojne, brenda mundesive qe kane, zgjidhjen e problemeve administrative dhe financiare qe dalin nga zbatimi i kesaj Marreveshjeje.

Secila Pale kontraktuese lehteson, ne baze te legjislacionit te saj, qarkullimin dhe qendrimin e shtetasve te Pales tjeter qe kryejne nje veprimtari qe rrjedh nga zbatimi i kesaj Marreveshjeje.

Neni 15

Secila nga Palet kontraktuese do te perfitoje, ne kufite dhe kushtet e vendosura nga legjislacioni i shtetit qe pret, nga perjashtimi prej te gjitha detyrimeve dhe taksave per objektet me karakter kulturor te importuara per zbatimin e kesaj Marreveshjeje.

Neni 16

Personat e parashikuar ne Nenin 6, gjate kohes se funksionit te tyre, do te perfitojne importimin pa taksa te mobiljeve te tyre dhe te objekteve personale, ne perdorim te tyre gjate instalimit te pare, te automjetit dhe rieksporimit e tyre duke qene te perjashtuar nga te gjitha detyrimet e taksat.

Keto dispozita nuk do te shtrihen per personat shtetas te shtetit prites ose ata me qendrim te perhershem ne kete shtet.

Neni 17

Do te krijohet nje komision i perbashket kulturor, shkencor e teknik franko-shqiptar, i cili do te zevendesoje Komisionin e Perbashket te meparshem, qe ka mbajtur sesionin e tij te fundit ne Tirane me 25 e 26 qershor 1987.

Ky Komision do te shqyrtoje te gjitha çeshtjet qe kane te bejne me zbatimin e Marreveshjes se tanishme. Ai do te perpunoje nje Program periodik te shkembimeve dhe te bashkepunimit dhe te fiksoje modalitetet e tij. Ai do te mblidhet me radhe ne Paris dhe ne Tirane, sipas nje periudhe, e cila do te percaktohet nga te dyja Palet.

Neni 18

Secila Pale do t'i njoftoje Pales tjeter plotesimin a procedurave kushtetuese te nevojshme per hyrjen ne fuqi te kesaj Marreveshjeje, e cila do te jete a vlefshme ne daten kur do te njoftohet perfundimi i ketyre procedurave.

Neni 19

Kjo Marreveshje do te jete e vlefshme per pese vjet dhe do te riperterihet ne menyre te heshtur per periudha te tjera te njejta. Ajo mund te denoncohet ne çdo kohe nga njera ose tjetra Pale duke njoftuar gjashte muaj perpara.

Perfaqesuesit e plotfuqishem te dy qeverive qe jane autorizuar kane nenshkruar kete Marreveshje dhe e kane vulosur.

BERE ne Tirane, me 17 shkurt 1988 ne dy ekzemplare origjinale nje ne frengjisht, tjetri ne shqip duke pasur te dy tekstet vlere te barabarte.

Per Qeverine
e Republikes Franceze:

[*Signed — Signé*]

DIDIER BARIANI

Per Qeverine
e Republikes Popullore Socialiste
te Shqiperise:

[*Signed — Signé*]

ALFRED UÇI